



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 586, datë 22.7.2020

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BASHKIMIT EVROPIAN, PËR PROJEKTIN "EU4SCHOOLS"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes së bashkëpunimit me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për projektin "EU4schools", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDIRAMA

MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBEN AHMETAJ

Drejtuar: Z. Luigi Soreca
AMBASADOR
DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN NË SHQIPËRI

I nderuar Z. Ambasador,

Në vijim të shkresës Tuaj Ref Area(2020)2792679, datë 29.05.2020, në lidhje me Projektin të financuar nga Bashkimi Evropian për programin “EU4Schols” në masën prej 15(pesëmbëdhjetë) milion Euro, kam nderin, që në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të shpreh në parim dakordësinë në lidhje përsa më poshtë.

Projekti do të zbatohet në koordinim të plotë me Qeverinë Shqiptare (përfshirë Komisionin Shtetëror për Rindërtim).

Procesi i prokurimit dhe zbatimi i projektit do të ekzekutohet nga UNDP në përputhje me standardet shqiptare dhe standardet e Bashkimit Evropian.

Mbikëqyrja e punimeve do të realizohet nga UNDP dhe do të merret në dorëzim nga bashkitë Durrës, Krujë, Kurbin, Kamëz, Kavajë.

Të gjithë detyrimet ligjore dhe detyrimet ndaj palëve të treta në sheshet e ndërtimit mbeten përgjegjësi e autoriteteve kompetente, përkatësisht bashkive.

Bashkitë respektive do të marrë përsipër të garantojë vendosjen në dispozicion të donatorit, të sheshit të ndërtimit. Nëse ka probleme me zonimin dhe pronësisë, do të zgjidhen nga autoritetet kompetente.

Bashkitë respektive do të marrin përsipër t'i garantojnë vendosjen në dispozicion të donatorit, të gjithë dokumentacionit të nevojshëm (leje, licenca autorizime etj.) për kryerjen e punëve.

Granti që siguron burimet për projektin i nënshtrohet të gjitha dispozitat ligjore në fuqi për përjashtimet përkatëse fiskale, në rast të fatkeqësive natyrore, në kuadër të procesit të rindërtimit.

Nota Juaj me ref. Area(2020)2792679, datë 29.05.2020 dhe kjo notë e përgjigjes në të cilën shprehet miratimi i Qeverisë shqiptare, do të përbëjnë një marrëveshje me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për projektin “EU4SCHOOLS, e cila do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga Bashkimi Evropian të njoftimit të shkruar nga pala shqiptare, për përfundimin e

procedurave të nevojshme të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Pranoni zoti Ambasador sigurimet e konsideratës më të lartë,

Ministri i Shtetit për Rindërtim

Arben Ahmetaj

NR.PROT. 3735/1
DATË 27-7. 2020

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

